

# INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME PËR INSTRUMENTET FINANCIARE

---



## Informacion për bankën

Për të informuar plotësisht klientët, përpara se të marrin vendime për investime, Banka Ekonomike Sh.a do të ju ofron klienteve informacione të përgjithshme dhe në formë të kuptueshme lidhur me instrumentet financiare në të cilat klientet do të mund të investojnë, në mënyrë që klientet mund të kuptojnë brenda një kuadri të arsyeshëm natyrën dhe rreziqet e investimit, si dhe specifikat e llojeve të ndryshme të instrumenteve financiare, siç janë , aksionet, fondet e tregtueshme (ETF), bonot e thesarit dhe obligacionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

## Të dhëna të përgjithshme për Bankën

Emri: Banka Ekonomike Sh.a  
Adresa: Sheshi Nena Tereze, p.n 10000, Prishtinë  
www.bekonomike.com  
www.info@bekonomike.com  
Telefoni: +383 (0) 38 500 500  
SWIFT: **EKOMXKPRXXX**  
BLOOMBERG Dealing Code: BEKO

## Kostot dhe tarifat

Banka është e detyruar t'u sigurojë me kohe klientëve informacion të qartë dhe gjithëpërfshirës për të gjitha kostot dhe tarifat.

Të gjitha të dhënat mbi tarifat që do aplikohen nga banka për shërbimin i cili do ju mundeson klienteve të bankës qasje për investime në disa bursa boterore, do të jenë të renditura dhe publikuara në ueb të bankës (Tarifat) të ofruara nga Banka (në tekstin e mëtejme: Lista e çmimeve) të cilat do të jenë të disponueshme për çdo klient.

Banka do të njoftojë klientët për kostot, tarifat dhe stimujt shtesë lidhur me ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit në kohën e duhur, përpara nënshkrimit të kontratave për shërbimet dhe aktivitetet e listuara, me qëllim të sigurohemi që klienti të ketë mundësinë të marrë informatat e nevojshme lidhur me pjesën e tarifave dhe specifikave tjera para një vendimi për investim.

Sa herë që një pjesë e kostove dhe tarifave totale është e shprehur në një valute të huaj për pagesë nga ana e klientit, banka do të realizoj konvertim në EUR për pagesë të shërbimit, sipas listës së çmimeve të cilën klienti do e ketë në dispozicion para investimit.

*Shënim: Banka Ekonomike rezervon të drejtën të ndryshoj, limitet bazë për investime, shumat dhe përqindjet e tarifave të tij/saj, ndryshime për të cilat klientët do të jenë të informuar në kohë përmes kanaleve zyrtare të informimit.*

## Instrumentet financiare në dispozicion të klienteve për investime

- Aksionet e tregtuara në bursa botërore
- Fondet e tregtuara në bursë(ETF)
- Bonot e Thesarit dhe obligacionet e Qeverise së Kosovës,

## Paralajmërime për investitorët

Gjatë tregtimit të produkteve financiare, si dhe, vendimit për të blerë ose shitur instrumente financiare, klienti duhet t'i kushtojë vëmendje rreziqeve që bartin investimet në ato produkte financiare të cilat mund të rezultojnë me fitime apo humbje nga investimi.

Rreziku mund të përkufizohet si njohja e një situate në të cilën mund të ndodhin një sërë rezultatesh (pozitive, negative) si rezultat i një vendimi, probabiliteti i arritjes së secilit rezultat mund të jetë i njohur ose mund t'i nënshtrohet vendimit personal nga vendimmarrësi.

Qëllimi kryesor i investitorit është të arrijë një kthim pozitiv nga investimi, megjithatë, çdo investim në produkte financiare bartë në vete një rrezik të ndërlidhur me: rrezikun e likuiditetit, rrezikun e tregut, kursit valuator dhe tjera.

1. Rreziku i likuiditetit; - është rreziku i pamundësisë për të blerë ose shitur instrumente financiare shpejt pa humbje të vlerës, për shkak të likuiditetit të ulët në treg apo kërkesës së zvogëluar.
2. Rreziku i tregut - është rrezik i ndryshimit të vlerës (rritjes ose uljes) së investimit për shkak të çmimit apo ndryshimeve në lëvizjet e tregjeve financiare.
3. Rreziku valutor – është i lidhur me rrezikun e ndryshimeve të kursit të këmbimit, p.sh.nëse aksioni është i listuar në bursa të ndryshme në valuta në ndryshme (p.sh. aksionet amerikane kuotohen në euro në bursën e Frankfurtit) ajo mbart me vete rrezikun valutor.
4. Rreziqe të tjera- ndaj të ardhurave dhe kapitalit që lindin si rezultat i vendimeve joadekuate të biznesit ose zbatimi jo i duhur i tyre;

Prandaj, investimi mund të mos sigurojë kthimin e pritur ose të çojë në një humbje të investuar kapitale. Në përgjithësi, ekziston një lidhje lineare midis shumës së kthimit të pritur dhe normës së riskut, dmth. sa më i lartë të jetë kthimi i pritur, aq më i madh është rreziku i humbjes.

Produket financiare të ndryshme kanë risqe të ndryshme. Si rregull i përgjithshëm, një metodë për të kufizuar rrezikun e humbjes është investimi në një grup instrumentesh financiare, dhe jo në një, ose më shumë letra me vlerë të ngjashme (parimi i diversifikimit të rrezikut).

Përshkrime të përgjithshme për disa instrumente financiare në të cilat klientët e bankës mund të investojnë janë dhënë më poshtë;

## Aksionet

Një aksion është një vlerë me të cilën investitori provon investimin e tij në kapitalin e aksionit të përbashkët të një kompanie. Aksionet janë instrumente financimi afatgjatë pa një maturim të paracaktuar, pra kthim mbi shumën e investuar.

Një nga karakteristikat themelore të aksioneve është të japë një dividend (i cili i referohet pjesës së aksionerit në fitimin që ka realizuar shoqëria aksionare në një periudhë të caktuar). Kthimi nga investimi i kapitalit konsiston në pagesën e dividendit si dhe fitimin dhe humbjen bazuar në diferencën në çmimin e aksionit, që do të thotë se kthimi nuk mund të parashikohet me siguri.

Shuma e dividendit shprehet si vlerë absolute për aksion ose si përqindje e vlerës nominale të aksionit. Shumica e të ardhurave nga investimet e kapitalit zakonisht realizohen nga performanca e lëvizjes së çmimit të aksionit.

## Fondet e tregtuara në bursë (ETF)

Fondet e tregtuara në bursë (ETF), janë një lloj instrumenti financiar që ndjekin një indeks, mall, sektor ose ndonjë aktiv tjetër, por që mund të blihen ose shiten në bursë në të njëjtën mënyrë si tregtohet një aksion i zakonshëm. Një ETF mund të strukturohet për të ndjekur çdo gjë, nga çmimi i një malli deri të një koleksion i larmishëm letrash me vlerë. Gjithashtu, ETF-të mund të strukturohen për të ndjekur një strategji specifike të investimit.

- Një ETF është një shporte instrumentesh financiare (letrave me vlerë) që tregtohen në bursë ashtu si një aksion i zakonshëm.
- Çmimet e aksioneve të ETF-ve kanë volatilitet (paqëndrueshmëri) përgjatë gjithë ditës në varësi të kërkesës dhe ofertës.
- ETF-të mund të përmbajnë të gjitha llojet e investimeve, duke përfshirë aksionet, mallrat dhe Obligacionet.
- Për dallim nga blerja e aksioneve të veçanta, ETF-të ofrojnë raporte apo Norma me të ulëta të shpenzimeve dhe komisioneve për blerje.

Dallimi kryesor midis një Fondi Investimi dhe Fondi të tregtuar në Bursë (ETF) është mënyra se si tregtohen dhe menaxhohen.

ETF-të mund të tregtohen si aksione, për dallim nga fondet e përbashkëta të investimit të cilat mund të blihen vetëm në fund të çdo dite tregtimi duke u bazuar në një çmim të përlogaritur. Ndërsa, ETF-të nga ana tjetër, menaxhohen në mënyrë pasive dhe bazohen thjeshtë në një indeks të caktuar tregu.

Në vazhdim janë të listuara disa burime për hulumtime të informacioneve të cilat ju mund t'i shfrytëzoni për hulumtim të aksioneve të kompanive, çmimeve, lajmeve, statistikave dhe vlerësimeve. <https://www.investing.com/>, <https://finance.yahoo.com/>, <https://www.investopedia.com/>, <https://seekingalpha.com/>, <https://finviz.com/>, <https://www.google.com/finance/>, <https://etfdb.com/>, <https://www.teletrader.com/>, <https://www.marketwatch.com/>, <https://www.bloomberg.com/>, <https://www.koyfin.com/>.

## Bonot e Thesarit dhe Obligacionet Qeveritare

Janë instrumente financiare të tregtueshme të cilat leshohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Bonot e Thesarit kanë maturitetin jo më të gjatë se 1 vit, ndërsa, Obligacionet janë letra me vlerë afatgjata, me maturitet me të gjatë së 1 vit.

Bonot e thesarit janë me kupon zero ato nuk paguajnë kupone, këto leshohen me ulje ndërsa kur shlyhen në maturitet paguhen sipas vlerës reale 100%. Fitimi ne Bonot e Thesarit është diferenca mes vlerës ne maturitet dhe vlerës së paguar në ditën e blerjes.

Kur një investitor blen Obligacione, ata në fakt i japin kredi shtetit apo korporates nga cila i blejnë keto letra me vlerë, nga i cili investim ata përfitojnë interes periodik (në një apo më shumë data të caktuara përgjatë vitit) në formë të kuponëve të interesit. Ndërsa në datën e maturimit të obligacionit, investitorët marrin shumën e plotë të investuar në fillim.

Shuma minimale për të marrë pjesë në ankande të letrave me vlere (tregun primar) është 50,000.00 eur.

Nese shuma e mjeteve për investim është me e ulet se 50,000.00 eur, por Jo nen 10,000.00 eur, Banka Ekonomike i ofron për shitje klienteve në treg sekondar letrat me vlere të cilat I ka blere në ankand.

Për me shumë informata rreth kalendarit të emitimeve të letrave me vlere nga Qeveria e Republikës së Kosovë, mund t'i gjeni në linkun: <https://bqk-kos.org/shpalljet/letrat-me-vlere-te-qeverise/ankandet/>